




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.T.SH. "ELEKTRA"  
Numri i biznesit 80283989  
Pronar – Hebib DERNJANI  
Mediakos COMMUNICATIONS  
Hani i Elezit



**VENDIM**

për ndërprerjen e licencës të operatorit të shpërndarjes Mediakos Communications, me seli në  
Han të Elezit

**Faktet**


1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Mediakos Communications është operator i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregulloren KPM-2016/01, me seli në Han të Elezit. KPM, me datën 1 gusht 2008, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorin e shpërndarjes Mediakos Communications, ndërsa më datën 1 gusht 2018, KPM ka marr vendim për ripërtëritjen e kësaj licence.
3. Më datën 12 dhjetor 2019, pronari i operatorit të shpërndarjes Mediakos Communications, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM me anë të e-mailit, ka njoftuar se heq dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.

**Arsyetimi**

4. Duke marrë parasysh njoftimin e pronarit të operatorit të shpërndarjes Mediakos Communications, për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga licenca, Komisioni konstaton se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së Mediakos Communications.

## Vendim

5. Komisioni në takimin e tij të mbajtur më datë 21 janar 2020, merr vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes Mediakos Communications, në bazë të njoftimit për heqje dorë në mënyrë vullnetare nga Licenca e KPM-së.
6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.



Muja FERATI

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



04.02.2020

datë